



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
**Komuna e Kaçanikut**  
Opština Kaçanik/Municipality of Kaçanik



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data	19.01.2026	ndi	KAÇANIK
	Nj. org.		Numri	Shtojcë
	01	104/02-	1729	28

## PLANI I PUNËS PËR VITIN 2026



*Kaçanik, Janar 2026*

## PËRMBAJTJA

Fjala e Kryetarit.....	3
Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njërzore.....	5
Zyra e Prokurimit.....	12
Njësia e Auditimit të Brendshëm.....	14
Zyra Ligjore .....	16
Inspektorati i Komunës .....	19
Zyra e Teknologjisë Informative .....	25
Zyra e Informimit .....	27
Zyra për Komunitete dhe Kthim.....	36
Zyra për Barazi Gjinore.....	39
Zyra për Integrimi Evropiane.....	44
Zyra e Kuvendit Komunal .....	47
Drejtoria e Administratës së Përgjithshme .....	48
Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.....	58
Drejtoria e Arsimit.....	71
Drejtoria e Buxhetit dhe Financave .....	79
Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mejdisit.....	92
Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural .....	108
Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.....	114
Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit .....	119

## Fjala e Kryetarit

Të nderuar qytetarë të Komunës së Kaçanikut,

Ky Plan Pune për vitin 2026 pasqyron angazhimin tim dhe të Ekzekutivit të Komunës për një qeverisje lokale të përgjegjshme, transparente dhe të orientuar drejt rezultateve konkrete për qytetarët. Ky vit synon të shërbejë si një hap i rëndësishëm drejt forcimit të shërbimeve publike, zhvillimit ekonomik lokal dhe përmirësimit të infrastrukturës publike, duke e bërë Kaçanikun më funksional dhe gjithëpërfshirës.

Plani është ndërtuar mbi bazën e nevojave reale të qytetarëve, prioritetëve zhvillimore të komunës dhe në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi. Për vitin 2026, synojmë veçanërisht:

- Përmirësimin e cilësisë së shërbimeve arsimore dhe shëndetësore;
- Investime kapitale në infrastrukturën publike dhe rrugore;
- Zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe krijimin e mundësive të reja për qytetarët;
- Thellimin e transparencës, llogaridhënies dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje;
- Bashkëpunim të ngushtë me partnerë lokalë, qendrorë dhe ndërkombëtarë për projekte strategjike.

Jam i bindur se me përkushtim institucional, bashkëpunim të ndërsjellë dhe pjesëmarrje aktive të qytetarëve, viti 2026 do të shënojë një hap të ri përpara në zhvillimin dhe transformimin e komunës sonë.

## **Struktura Organizative e Ekzekutivit të Komunës**

Ekzekutivi i Komunës ushtron aktivitetin e tij përmes 9 drejtorive komunale, si dhe njësive dhe zyrave që veprojnë në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës.

### **Drejtoritë Komunale:**

- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- Drejtoria e Arsimit
- Drejtoria e Buxhetit dhe Financave
- Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
- Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës
- Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit

### **Njësitë dhe Zyrat në kuadër të Kabinetit të Kryetarit:**

- Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Zyra e Prokurimit
- Njësia e Auditimit të Brendshëm
- Zyra Ligjore
- Zyra e Inspektoratit
- Zyra e Teknologjisë Informative
- Zyra e Informimit
- Zyra për Komunitete dhe Kthim
- Zyra për Barazi Gjinore
- Zyra për Integritet Evropian
- Zyra e Kuvendit Komunal

## Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore, në kuadër të komunës, funksionon në kuadër të Zyres së Kryetarit të Komunës dhe kryen detyrat e punës të përcaktuara si në Ligjin për zyrtarët publikë dhe akte tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë zhvillimin e procedurave në fushën e burimeve njerëzore si më poshtë:

*“Ofrimi i mbështetjes për Kryetarin e Komunës në fushën e burimeve njerëzore, përgatitja e Planit të personelit në përputhje me procesin e planifikimit buxhetor të Institucionit, zhvillimin e procedurave për pranimit të zyrtarëve publikë, menaxhimin e proceseve të ndërlidhura me emërimin dhe përfundimin e marrëdhënies së punës, ofrimi i ndihmes dhe mbështetjes njësive përkatëse dhe komisioneve lidhur zhvillimin e procedurave tjera, administrimi i planeve dhe dosjeve individuale përmes SIMBNJ-së dhe detyra tjera të përcaktuara me legjislacioni në fuqi.*

Gjatë vitit 2026, Njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore, ka paraparë që të realizojë aktivitetet dhe detyrat konkrete në kuadër të këtyre objektivave :

- Menaxhimi dhe koordinimi i punëve sipas Ligjit Nr. 08/L-197 për zyrtarët publikë dhe rregulloret për procedurat përkatëse të nxjerra në bazë të këtij Ligji.
- Zbatimin e ligjit Nr. 08/L-196 për pagat në sektorin publik
- Mirëmbajtja e dhe plotësimi i dosjeve të personelit në kopje fizike dhe elektronike
- Raportimi i rregullt për udhëheqësin më të lartë administrative dhe në organet qendrore lidhur me çështjet e personelit

Aktivitetet e planifikuara për vitin 2026, detyrat konkrete, koha dhe mënyra e implementimit tyre do të bëhet si në tabelën më poshtë:

Aktivitetet e planifikuara	Koha dhe vendi i implementimit të aktiviteteve		Rezultatet e pritura nga aktivitetet e zhvilluara	Partnerët implementues të aktiviteteve
	Koha	Vendi		
<b>1. Menaxhimi dhe koordinimi i punëve sipas Ligjit Nr. 08/L-197 për zyrtarët publikë dhe Rregulloreve për procedurat përkatëse të nxjerra në bazë të këtij ligji.</b>				
Zhvillimi i procedurave të rekrutimit sipas LZP-së nr. 08/L-197 dhe rregulloreve përkatëse për pranimin e zyrtarëve publikë si dhe Planit të personelit për vitin 2026. Zhvillimi i procedurave në shërbimin civil bëhet përmes sistemit informativ për menaxhimin e burimeve njerëzore (SIMBNJ-së) ndërsa, për nëpunësit e shërbimit publik dhe nëpunësit teknik dhe mbështetës konkursi hapet përmes portalit për rekrutim elektronik por procedura zhvillohet në formë fizike	janar – dhjetor 2026	Njesia për menaxhimin e burimeve njerëzore (NJMBNJ)	Zhvillimi i procedurave të rekrutimit sipas planit të personelit. Informimi me kohë, i drejtë dhe i saktë për vendet e lira të punës, Përzgjedhja e kandidatëve sipas meritës.	NJMBNJ, MPB, Kryetari i Komunës

1.1 Zhvillimi i procedurës së emërimit të zyrtareve të ri dhe periudhës provuese	Janar-shkurt		Emërimi i zyrtareve të ri.  Sipas këtij plani , përcaktohen qartë objektivat për çështjet e personelit,përshkruhet gjendja ekzistuese e personelit dhe planifikimi i ri si dhe ndryshimet tjera të mundshme të personelit	Menaxheri i burimeve njerëzore  Kryetari i Komunës,  Drejtorët e Drejtorive komunale  NJMBNJ  Drejtoret e drejtorive komunale.
1.2 Hartimin e Draft planit të personelit për të gjithë zyrtarët publik sipas nevojave të drejtorive përkatëse, në harmoni me planin e ndarjes buxhetore të shpenzimeve dhe dorëzimi i tij në DMZP-MPB.	Janar		Vlerësimi vjetor i zyrtarëve publike.  Përpilimi i raportit përmbledhës të vlerësimeve të nëpunësve civil dhe dorëzimi në DMZP-MPB.	Drejtoret e drejtorive komunale.  NJMBNJ,
1.3 Zhvillimi i procedurës së vlerësimit, caktimi i objektivave dhe vlerësimit vjetor i zyrtarëve publikë përmes SIMBNJ-së	Janar-dhjetor		Hartimi i vendimeve sipas rregulloreve për perfundimin e marrëdhënies së punës  Evidentimi i pushimeve vjetore, mjekësore, të lehonisë, pa pagesë etj.  - Kryerja e detyrave sipas Ligjit për zyrtarët publikë të dhe rregulloreve përkatëse siç është Procedura e ankesave dhe procedura disiplinore si dhe procedura tjera.	Kryetari i Komunës, Drejtoritë komunale.  Stafi ekzekutiv i Komunës, zyra e personelit dhe zyrtarët
1.4 Zhvillimi i procedurës së ndërprerje së marrëdhënies së punës	Janar – dhjetor		Zbatimi i orarit të punës nga të gjithë nëpunësit civil.	NJMBNJ
1.5 Zbatimi i Rregulloreve të pushimeve .			Menaxhimi dhe evidentimi i hyrje-daljeve në sistemin e kartelave	Stafi ekzekutiv i Komunës, zyra e personelit
1.6 Ofrimi i këshillave profesionale lidhur me				

<p>çështjet e personelit për udhëheqësin më të lartë administrativ (Kryetarin e Komunës), menaxherët drejtues si dhe përkrahje administrative për komisionet e formuara për zhvillimin e procedurave që kanë të bëjnë me çështjet e personelit. (burimeve njerëzore)</p>	<p>janar-dhjetor</p>		<p>Zbatimi i procedurave sipas rregulloreve në fuqi</p>	<p>dhe zyrtaret</p> <p>Stafi ekzekutiv i Komunës, zyra e personelit</p>
<p>1.7 Regjistrimi i të gjithë nëpunësve civil në sistemin e kartelave</p>	<p>janar dhjetor</p>			<p>NJMBNJ</p>
<p>1.8 Zhvillimi i procedurës së përshkrimit të vendeve të punës, klasifikimit të vendeve të punës dhe rregulloreve tjera për çështjet e personelit</p>				
<p><b>2. Zbatimi i ligjit Nr. 08/L-196 për pagat në sektorin publik</b></p>				

<p>2.1 Përgatitja e vendimeve për stafin, përcjellja e ndryshimeve të administrates komunale për sistemimin e tyre në sistemin e pagave, mbajtja e listave të pagave të nënshkruara në dosje elektronike si dhe kopje fizike .</p> <p>2.2 Qasja në listat e pagave dhe raportit financiar në sistemin e pagave.</p> <p>2.3 Menaxhimi, Ruajtja dhe nënshkrimi i listave të pagave</p>	<p>janar-Dhjetor</p>	<p>Zyra e personelit</p>	<p>Sistemimi i punëtorëve në sistemin e pagave sipas legjislacionit në fuqi. Mbikëqyrja e inkuorporimit të ndryshimeve në sistemin e pagave,</p> <p>Dërgimi i listave të pagave tek Kryetari i Komunes dhe Zyrtari Kryesor financiar</p> <p>Bartja e listave të pagave dhe raportit financiar nga sistemi i pagave dhe përcjellja e listave të zyrtarëve për nënshkrime dhe arkivimi i tyre.</p>	<p>Kryetari i Komunës, Zyrtare e NJMBNJ-se</p> <p>-Zyrtare e NJMBNJ-se</p>
--	----------------------	--------------------------	--	--

### 3. Mirëmbajtja e dhe plotësimi i dosjeve të personelit ne kopje fizike dhe elektronike

3.1 Kompletimi i dosjeve si dhe ruajtja e tyre në mënyrë shumë të sigurt dhe vend te sigurt.	janar – dhjetor	Njesia per menaxhimi ne burimeve njerëzore (NJMBNJ)	Ruajtja e dokumenteve fizike personale të të gjithë zyrtareve publikë.	NJMBNJ
3.2 Përditësimi me të dhëna të reja të personelit në sistemin e informimit të burimeve njerëzore (SIMBNJ)		Zyra e personelit	Evidentimi dhe ruajtja e tërë dokumentacionit personal të punëtorëve në SIMBNJ (Sist. elektronik)	NJMBNJ dhe MPB

### 4 Raportimi i rregullt në organet qendrore lidhur me çështjet e personelit

4.1 Raportimi lidhur me të punësuarit në administratë, arsim dhe shëndetësi për DMZP-në –MPB-në	Raporte vjetore Brenda afateve të kërkuara	Zyra e personelit		NJMBNJ
4.2 Përgjigje në ankesat e paraqitura në KPMSHCK	Raporte javore, mujore dhe vjetore			NJMBNJ
4.3 Raporte pune për Kryetarin e komunës	janar - shkurt			
4.4 Raporte për çështjet e personelit ne organet qendrore				

## Zyra e Prokurimit

AKTIVITETE E PLANIFIKUARA	KOHA DHE VENDI I IMPLEMENTIMIT		REZULTATET E PRITURA NGA AKTIVITETI I ZHVILLUAR	PARTNERËT IMPLEMENTUES TË AKTIVITETIT
	Koha	Vendi		
<b>I. RAPORTIMET</b>				
1.1 Përgatitja e Raporteve sipas udhëzimeve të KRPP-së lidhur me Kontratat e realizuara gjatë vitit 2025.	Janar- 2026	Kaçanik	Rritja e Transparencës dhe llogaridhënies	KRPP, ZKA,dhe Njosit kërkuese.
1.2 Përgatitja dhe dorëzimi i Planifikimit të Prokurimit per vitin 2026.	Janar- Dhjetorë			KRPP, ZKA,OSHP dhe Njosit kërkuese.
1.3 Përgatitja dhe percjellja e lëndëve për Auditim sipas planit të paraparë nga Auditori i brendshëm dhe Zyra Kombtare e Auditimit.	Janar- Dhjetorë			
1.4 Përgatitja e Vendimeve në rast kërkesave për Rishqyrtim dhe percjellja e Vendimeve OE.	Janar- Dhjetorë			
1.5 Përgatitje dhe përfaqsimi i AK në rast të kërkesave nga OE për Rishqyrtim pranë OSHP-së.	Janar- Dhjetorë			KRPP, ZKA,OSHP dhe Njosit kërkuese.

<b>2. UDHËHEQJA E PROCEDURAVE PËR FURNIZIME</b>				
2.1 Përgatitja e DT dhe publikimi i tenderëve për furnizime sipas kërkesave të Njësive kërkuese dhe të planit të punës të ekzekutivit të Komunës për vitin 2026, Publikimi përmes KRPP , Formimi i komisioneve vlersuese, Plotësimi dhe përcjellja e Form. Standard për OE pjesëmarrës në njoftimet për Kontrata, Njoftimi për Vendimin e AK për OE pjesëmarrës dhe KRPP.	Shkurt-Tetor 2026	Komuna e Kaçanikut	Funksionalitetin dhe efikasitetin e Administratë Komunale, Arsimit dhe Shëndetësisë.	Për implementimin e këtyre projekteve janë Autoriteti Kontraktues dhe OE (Operatorët Ekonomik)
<b>3. UDHËHEQJA E PROCEDURAVE PËR INVESTIMET KAPITALE</b>				
3.1 Përgatitja e DT dhe publikimi i tenderëve sipas listës së miratuar ne Kuvendin e Komunës, projektet kapitale për vitin 2026 Publikimi përmes KRPP , Formimi i komisioneve vlersuese Plotësimi dhe përcjellja e Form. Standard për OE pjesëmarrës në njoftimet për Kontrata. Njoftimi për Vendimin e AK për OE pjesëmarrës dhe KRPP.	Shkurt – Shtator 2026	Komuna e Kaçanikut	Krijimi i kushteve më të mira për të gjithë banorët e komunës sonë.	Për implementimin e këtyre projekteve janë Autoriteti Kontraktues dhe OE (Operatorët Ekonomik)
4. Trajnim i stafit 4.1 Trajnimet e obligueshme në fushën e Prokurimit	Qershor-Dhjetor 2026	Prishtinë	Avancim dhe profesionalizmi i stafit	IKAP, KRPP

## Njësia e Auditimit të Brendshëm

### Hyrje

Ky plan është përpiluar në bazë të Planit Strategjik të aktiviteteve të auditimit të brendshëm për periudhën 2026-2028, të miratuar nga Komiteti i Auditimit dhe të Aprovuar nga Kryetari i Komunës.

Plani vjetor për vitin 2026 paraqet zbatimin e detyrave të Auditimit të brendshëm të parapara me Planin Strategjik dhe të inkuorporuara në Planin Vjetor të Punës , të cilat do të kryhen në fushat e përcaktuara .

Në Planin Strategjik 2026-2028, janë përcaktuar fushat e auditimit për çdo vit, duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut për secilën fushë të auditimit.

Plani strategjik përkufizon fushëveprimin, objektivat, kohëzgjatjen dhe resurset e nevojshme për kryerjen e secilës detyrë të auditimit.

Detyrat e auditimit për 2026 janë përcaktuar në bazë të resurseve njerëzore që ekzistojnë në NJAB në momentin aktual.

Plani vjetor duhet të rishikohet rregullisht gjatë vitit dhe të azhurnohet sipas nevojës, në mënyrë që të mund të pasqyrojë ndryshimet me rëndësi që ndodhin në organizatë apo në Njësinë e Auditimit të Brendshëm, si dhe nga detyrat shtesë që propozohen nga udhëheqësi i organizatës.

Çdo ndryshim i planit vjetor do të aprovohet nga Kryetari i Komunës dhe Komiteti i auditimit.

### AKTIVITETET E NJËSISË SË AUDITIMI TË BRENDSHËM PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE

Në vitin 2026 Njësia e Auditimit të Brendshëm planifikon realizimin e detyrave dhe aktiviteteve për arritjen e Objektivave të theksuara në Planin Strategjik 2026-2028

Nr	Objektivi strategjik	Koha dhe vendi i implementimit të aktiviteteve	Aktivitetet për arritjen e objektivit	Detyrat
1.	Përmirësimi i funksionimit të komunës duke kryer një vlerësim të pavarur dhe objektiv të përshtatshmërisë dhe efektivitetit të kontrollit të brendshëm në të gjitha sistemet / strukturat e komunës;	Komuna e Kaçanikut Janar-dhjetor 2026	Analiza e nevojës për të zhvilluar rregulla dhe procedura të reja në përputhje me kërkesat e Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.	Angazhimet e sigurimit sipas planit vjetor

2	Përmirësimi i të kuptuarit të menaxhmentit për rolin e auditimit të brendshëm.	Komuna e Kaçanikut Janar-dhjetor 2026	Monitorimi dhe vlerësimi i efektivitetit dhe efikasitetit të proceseve të OB-së.  Vlerësimi i strategjive të prezantuara gjatë periudhës dhe qëllimeve të arritura.  Sigurimi i cilësisë së aktivitetit të auditimit të brendshëm dhe përmirësimi i kualifikimeve profesionale të auditorëve të brendshëm.	Angazhimet e sigurimit sipas planit vjetor
3	Ndihma e dhënë menaxhmentit për krijimin ose përmirësimin e proceseve të menaxhimit të rrezikut	Komuna e Kaçanikut Janar-dhjetor 2026	Shqyrtimi, vlerësimi, raportimi ose rekomandimi i përmirësimeve në lidhje me menaxhimin e rrezikut gjatë angazhimeve të shumta	Angazhimet e sigurisë sipas planit vjetor Angazhime të këshillimit
4	Ndihma e dhënë menaxhmentit në përcaktimin e qëllimeve strategjike dhe operative	Komuna e Kaçanikut Janar-dhjetor 2026	Vlerësimi nëse objektivat organizative e mbështesin dhe janë në përputhje me misionin e organizatës gjatë angazhimeve të shumta.	Angazhimet e sigurisë sipas planit vjetor
5	Dhënia e sigurisë menaxhmentit për menaxhimin e duhur, ligjor dhe efektiv të programeve dhe fondeve.	Komuna e Kaçanikut Janar-dhjetor 2026	Vlerësimi i: besueshmërisë së integritetit të informacionit financiar dhe operacional; ruajtjes së pasurive dhe pajtueshmërisë me ligjet, rregulloret, politikat, procedurat dhe kontratat.	Angazhimet e sigurisë sipas planit vjetor
6	Të vazhdohet zgjerimi i njohurive dhe aftësive profesionale të auditorëve të brendshëm dhe prezantimi i vetëvlerësimeve periodike	Komuna e Kaçanikut Janar-dhjetor 2026	Hartimi dhe zbatimi i një plani vjetor të trajnimit dhe të siguruarit e pjesëmarrjes së auditorëve të brendshëm në seminare dhe trajnime.	Plani vjetor i trajnimit për vitin 2026

# Zyra Ligjore

## Hyrje

Zyra Ligjore funksionon si njësi mbështetëse juridike brenda administratës komunale, me përgjegjësi kryesore sigurimin e ligjshmërisë, pajtueshmërisë normative dhe këshillimin juridik profesional për strukturat e komunës. Ky plan i punës përcakton qëllimet, fokusin strategjik dhe aktivitetet kryesore të Zyrës Ligjore për vitin 2026.

## Qëllimet Strategjike për Vitin 2026

1. Garantimi i ligjshmërisë dhe pajtueshmërisë normative në aktet dhe procedurat administrative të komunës.
2. Parandalimi i rreziqeve juridike dhe ofrimi i këshillave juridike.
3. Modernizimi i proceseve të punës dhe rritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve juridike.
4. Përmirësimi i dokumentimit dhe standardizimi i dokumenteve ligjore.
5. Zhvillimi profesional i stafit për t'u përgjigjur me cilësi ndaj sfidave ligjore të institucionit.

## Fushat Kryesore të Fokusit dhe Veprimet e Planifikuara

### 1) Këshillimi Ligjor dhe Pajtueshmëria

Objektivi: Ofrimi i analizave dhe vlerësimeve ligjore për aktet dhe procedurat e komunës.

Veprimet e planifikuara:

- Shqyrtimi ligjor i materialeve para miratimit nga institucionet komunale.
- Sigurimi i këshillimit juridik paraprak për strukturat e komunës në lidhje me legjislacionin në fuqi.

### 2) Organizimi dhe Menaxhimi i Dokumentacionit Ligjor

Objektivi: Rritja e efikasitetit dhe qartësisë në menaxhimin e dokumenteve juridike.

Veprimet e planifikuara:

- Krijimi i një sistemi të strukturuar të evidencave për çështjet ligjore.
- Standardizimi i dokumenteve ligjore dhe formave të përdorura në punë.
- Përgatitja e raporteve periodike mbi aktivitetet dhe materialet e shqyrtuara.

### 3) Modernizimi i Procesit të Punës

Objektivi: Rritja e efikasitetit operacional dhe transparencës së shërbimit ligjor.

Veprimet e planifikuara:

- Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet Zyrës Ligjore dhe njësive të tjera komunale.
- Përdorimi i mjeteve elektronike për dokumentim dhe ndjekje të çështjeve.
- Hartimi i raporteve të progresit të punës për menaxhim dhe strukturat përkatëse.

### 4) Parandalimi i Konfliktëve dhe Mosmarrëveshjeve

Objektivi: Ulja e rrezikut ligjor në veprimtarinë institucionale përmes masave parandaluese dhe zgjidhjeve alternative.

Veprimet e planifikuara:

- Këshillim juridik paraprak për aktet dhe vendimet me potencial rreziku.
- Sugjerimi i metodave alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve brenda institucioneve.
- Analiza e shkaqeve kryesore të mosmarrëveshjeve për parandalimin e përsëritjeve.

### Menaxhimi i Burimeve dhe Zhvillimi Profesional

#### 1. Forcimi i kapaciteteve të stafit:

- Organizimi i trajnimeve ligjore mbi legjislacionin aktual dhe praktikat më të mira.
- Promovimi i zhvillimit profesional dhe ndarjes së detyrave sipas fushave të ekspertizës.

## 2. Buxheti dhe burimet logjistike:

- Planifikimi i fondeve për funksionimin efikas të Zyres Ligjore.
- Sigurimi i mjeteve teknologjike për dokumentim, komunikim dhe menaxhim të çështjeve.

## Monitorimi dhe Vlerësimi i Performancës

Monitorimi do të bëhet nëpërmjet raporteve të rregullta të aktivitetit me indikatorë kryesorë:

- Numri i çështjeve të shqyrtuara dhe këshillave të dhëna.
- Reduktimi i çështjeve problematike për strukturat komunale.
- Efikasiteti në trajtimin e kërkesave ligjore dhe reagimeve.

Rezultatet e monitorimit do të përdoren për përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve dhe përcaktimin e prioriteteve për periudhat e ardhshme.

## Përfundime

Ky plan i punës për vitin 2026 synon që Zyra Ligjore të funksionojë si një strukturë e dobishme, efikase dhe profesionale që siguron standardet më të larta të ligjshmërisë dhe këshillimit juridik për Komunën e Kaçanikut. Zbatimi i tij do të kontribuojë në qeverisje më transparente, efikase dhe të besueshme për qytetarët.

## Inspektorati i Komunës

Aktivitetet e planifikuara	Koha dhe vendi i implementimit të aktiviteteve		Rezultatet e pritura nga aktivitetet e zhvilluara	Partnerët implementues të aktiviteteve	Buxheti	
	Koha	Vendi			Komuna	Donacione
<b>1. Inspektimi në Komunikacionin Rrugor</b>						
<p>1.1 Inspektimi në komunikacion, përfshirë transportin publik të udhëtarëve me autobusë në linjat urbane - periferike, kombi bus dhe autotaksi;</p> <p>1.2 Inspektimi i automjeteve me mbingarkesë të barrës,</p> <p>Inspektim në trafikun urban dhe urbano-periferik,</p> <p>1.3 Inspektimi dhe kontrollë e sinjalizimit horizontal dhe vertikal te shenjave të komunikacionit;</p> <p>1.4 Inspekton transportin e mallërave;</p>	Janar – Dhjetor 2026	Komuna	<p>1.1 Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve sa më efikase në transportin publik të udhëtarëve, në vijat e rregullta dhe ato jashtë linjore sipas ligjeve në fuqi dhe rregullores komunale për transport publik të udhëtarëve;</p> <p>1.2 Ndalimi i mbingarkesës për autobusë dhe kombi bus, respektimi i orarit dhe rendit të udhëtimit si dhe të ofrohet një shërbim më efikas në transportin publik.</p> <p>Në rast se operatorët veprojnë në kundërshtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi, atëherë do të merren masa konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.</p> <p>1.3 Kontrollon shenjat e dëmtuara- dëmtimi i shenjave të komunikacionit, dëmtimi i shenjave të emërimit të rrugëve publike,</p>	<p>Spektori i Inspektoratit – Inspektori i Komunikacionit,</p> <p>Puna ekipore e përbashkët e inspektorëve;</p> <p>Policia e Kosovës,</p> <p>Inspektorët e nivelit qendror,</p> <p>Përmbaruesi,</p> <p>Prokuroria dhe Gjykata.</p>		

1.5 Bashkëpunon dhe inspekton me policinë e Kosovës - trotuaret dhe parkingjet publike;			<p>rekomandon vendosjen e shenjave të komunikacionit dhe lokacionet për vend parkime nëpër rrugë dhe hapësira publike;</p> <p>1.4 Transportuesit e mallrave të kompletohen me dokumentacionin përkatës;</p> <p>1.5 Kontrollë parkingjet publike, parkingjet ilegale dhe lirimi i trotuareve me qëllim të krijimit të rregullit në komunikacion, duke mundësuar rritjen e sigurisë në komunikacion dhe duke mundësuar lëvizjen e pa penguar të këmbësorëve;</p>			
<b>2. Inspektimi i Ndërtimeve</b>						
<p>2.1 Kontrollimi i ndërtimeve në tërë territorin e komunës sonë,</p> <p>2. Mbajtja e procesverbaleve mbi gjendjen e punimeve</p> <p>nëpër objektet e inspektuara;</p> <p>3. Dhënia e urdhëresave mbi ndalimin e ndërtimeve dhe</p> <p>Aktvendimeve për ndalimin e ndërtimeve, të cilat zhvillohen në kundërshtim me lejen e lëshuar nga drejtorja;</p> <p>4. Dhënia e Aktvendimeve mbi rrënimin e objekteve të ndërtuara pa leje, ose të objekteve të cilët janë duke u ndërtuar pa leje;</p>	Janar – Dhjetor 2026	Komuna	<p>1. Parandalimi i ndërtimeve pa leje si dhe vetëdijësimi i qytetarëve që të pajisen me dokumentacione për leje ndërtimi nga drejtorja përkatëse.</p> <p>2. Parandalimi i ndërtimeve të egra duke marr masa konform ligjeve në fuqi.</p> <p>3. Parandalimi dhe vetëdijësimi i qytetarëve për të vepruar konform lejes ndërtimore.</p>	<p>Spektori i Inspektoratit – Inspektori i Ndërtimit,</p> <p>Puna ekipore e përbashkët e inspektorëve;</p> <p>Inspektorët e MMPHI-së,</p> <p>Policia e Kosovës,</p> <p>Përmbartuesi, Prokuroria dhe Gjykata;</p>		

3. Inspektimi në Mbrojtjen e Mjedisit						
<p>1. Inspekton ndotjen e ajrit, dheut të shkaktuara nga veprimtaritë industriale,</p> <p>2. Inspekton kontaminimin, mbeturinat, materiet e rrezikshme dhe zonat e mbrojtura në natyrë.</p> <p>3. Mbikëqyrjen e menaxhimit dhe eksploatimit të resurseve natyrore.</p> <p>4. Mbikëqyrja e punëve të gurëthyesve.</p> <p>5. Inspektimi i një varg veprimtarive pa njoftim të pronarit.</p> <p>6. Mbikëqyrja dhe mbrojtja e ambientit në aspektin e mbeturinave, kanalizimit, ujit.</p> <p>7. Bën planifikimin lokal të ambientit, masat tjera mbrojtëse ndaj zhurmës, trafikut.</p>	<p>Janar – Dhjetor 2026</p>	<p>Komuna</p>	<p>1. Parandalimi i ndotjes së Mjedisit, përfshirë ndotja e ujit, e ajrit, tokës, të cilët do të ndikonin negativisht në shëndetin publik të qytetarëve të komunës sonë.</p> <p>2. Parandalimi i shfrytëzimit të pakontrolluar të resurseve natyrore gjatë eksploatimit të gurit.</p> <p>3. Parandalimi i shkatërrimit ose degradimit të pyjeve dhe monumenteve të mbrojtura të natyrës.</p> <p>4. Parandalimi i keqpërdorimit dhe shfrytëzimit të pakontrolluar të resurseve natyrore nga operatorët që bëjnë eksploatimin e gurit;</p>	<p>Spektori i inspektoratit-</p> <p>Inspektori mjedisor;</p> <p>Puna ekipore e përbashkët e inspektorëve;</p> <p>Policia e Kosovës;</p> <p>Inspektorati mjedisor nga niveli qendror,</p> <p>Përmbauesi,</p> <p>Prokuroria dhe Gjykata.</p>		

<p>8. Bën procesverbale dhe fletëparaqitje për shkelësit e propozon masa për dispozitave ligjore dhe eliminimin e faktorëve që ndikojnë në ndotjen e ambientit.</p>						
<p><b>4. Inspektimi në lëminë e Shërbimeve Publike</b></p>						
<p>1. Inspekton vendosjen e reklamave nëpër hapësira publike;</p> <p>2. Inspekton dhe intervenon në raste kur dëmtohet prona komunale, si psh. prerja e asfaltit, vendosja e pengesave nëpër rrugë, dëmtimi i trotuareve, dëmtimi i shtyllave të ndriçimit publik, dëmtimi i rrjetit të kanalizimit, dëmtimi i rrjetit të ujësjellësit pa leje komunale etj.</p> <p>3. Parandalon dhe largon shitësit ambulancë që mallin e tyre e</p>	<p>Janar – Dhjetor 2026</p>	<p>Komuna</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Parandalimi i vendosjes së reklamave pa leje paraprake komunale;</li> <li>2. Të ruhet prona publike dhe intervenimet në pronë publike të bëhen vetëm me leje komunale;</li> <li>3. Paraprakisht paralajmërim për lirim të hapësirës publike, më pastaj urdhëresë, shqiptimi i gjobave deri te dërgimi i lëndëve tek përmbartësi, prokuroria dhe në Gjykata.</li> <li>4. Paraprakisht vërejtje për largimin e karrigave dhe tavolinave nga trotuaret, për të vazhduar me ndërmarrje të veprimeve përmes shqiptimit të gjobave deri te dërgimi i lëndëve tek përmbartësi dhe në gjykatë.</li> </ol>	<p>Spektori i Inspektoratit – Inspektori i shërbimeve publike,</p> <p>Puna ekipore e përbashkët e inspektorëve;</p> <p>Policia e Kosovës,</p> <p>Përmbartësi, Prokuroria dhe Gjykata.</p>		

<p>ekzpozojnë nëpër hapësira publike – pa leje komunale.</p> <p>5. Parandalon dhe bën lirimin e trotuareve nga ekspozimi i karrikave dhe tavolinave të bizneseve të ndryshme.</p> <p>6. Prandalon dhe bën largimin e mallit të ekspozuar para lokaleve afariste,</p>			<p>5. Paraprakisht paralajmërim për lirimin e hapësirës publike – shitës ambulant, kioska pa leje komunale etj, më pastaj urdhëresë, shqiptimi i gjobave deri te dërgimi i lëndëve tek përmbaruesi, prokurori edhe në Gjykata.</p>			
<p><b>5. Inspektimi në lëminë e tregut</b></p>						
<p>1. Kontrollimi dhe mbikëqyrja e tregut dhe të subjekteve të biznesit, nga kompetencat e lejuara me dispozitat ligjore nga kjo lëmi;</p> <p>2. Kontrollon dhe mbikëqyrë funksionimin e lokaleve afariste të të gjitha subjekteve biznesore – ekonomike;</p> <p>3. Kontrollë dhe pranim i kushteve teknike dhe regjistrimet e të gjitha subjekteve afariste;</p> <p>4. Inspekton respektimin e Rregulloreve të caktuara lidhur me Licencimin e bizneseve, mbishkrimet e firmave, zbatimin e orareve të punës, etj.</p>	<p>Janar – Dhjetor 2026</p>	<p>Komuna</p>	<p>1. Funksionim sa më i mirë i të gjitha lokaleve afariste të subjekteve biznesore.</p> <p>2. Korrektësi dhe deklaram i drejtë i cilësisë së produkteve ushqimore si dhe çmim transparent.</p> <p>3. Minimizimi deri në eliminimin e tregtisë jo formale.</p> <p>4. Paisjen me pëlqimin e kushteve teknike, higjienë - sanitare të të gjithë subjekteve afariste.</p> <p>5. Respektimin e Orarit te Punës ashtu si është rregulluar me ligj dhe me rregullore komunale, përfshirë bizneset afariste, kafiteritë, barnatoret farmaceutike etj.</p>	<p>Sektori i Inspektoratit – Inspektori i tregut,</p> <p>Puna ekipore e përbashkët e inspektorëve;</p> <p>Policia e Kosovës, Përmbaruesi, Prokuroria dhe Gjykata.</p>		

<p>5. Inspektim subjektet ekonomike dhe tregjet nga aspekti i prejardhjes së mallrave, pastaj ndalon shitjen jashtë lokaleve afariste (tregëtinë joformale) dhe punë të tjera të ngjashme sipas ligjit dhe akteve të tjera komunale;</p> <p>6. Kontrollimin e mjeteve matëse (peshoreve) si dhe përputhjen e gramazhës së bukës me deklarimin e saj.</p> <p>7. Kontrollimi i tregut të gjelbërt si dhe tregut të kafshëve;</p>						
<p>7. Gjatë vitit 2026, planifikojmë:</p>						
<p>8. Plane operative për inspektime, të cilat do t'i implementojmë si ekip i inspektoratit, me kompetenca të ndara, ku sipas planeve të hartuara, do të kërkojmë bashkëpunim me policinë e Kosovës,</p> <p>9. Inspektime edhe ditëve pas orarit të rregullt të punës pra në mbrëmje dhe natën,</p> <p>10. Inspektime edhe ditëve të pushimit, varësisht nga kërkesat dhe ankesat e qytetarëve;</p> <p>11. Gjatë muajit të ramazanit të kemi inspektime pas orarit të rregullt të punës (pas iftarit);</p> <p>12. Në sezonin veror të shtojmë numrin e inspektimeve, për shkak të fluksit të madh të mërgimtarëve.</p>						

## Zyra e Teknologjisë Informative

Aktivitetet e planifikuara	Koha dhe vendi i implementimit të aktiviteteve		Rezultatet e pritura nga aktivitetet e zhvilluara	Partnerët implementues të aktiviteteve
	Koha	Vendi		
<b>1. Mirëmbajtja e Teknologjisë Informative dhe menaxhimi i tyre</b>				
- MIRËMBAJTJA E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE, INSTALIM TE PROGRAMEVE, PROGRAMIM ETJ.	Janar Dhjetor 2026	Në Komunë dhe të gjitha institucionet e Komunës	Ndërhyrje në kohë, me qëllim që zyrtarët të mos hasin vonesa apo pengesa në kryerjen e detyrave për shkak të çështjeve teknike të teknologjisë informative.	
<b>2. Fibër optik ne komune dhe shtrirja e rrjetit qeveritare neper institucionet e komunës</b>				
- Kycja e shkollave në rrjetin qeveritar	Janar Dhjetor 2026	Komuna	Implementimi i rrjetit qeveritar në institucionet e Komunës, me qëllim garantimin e një niveli më të lartë të sigurisë së bazave të të dhënave.	

3. Server për shënime ( Centralizim te shënimeve ne Komune)				
Administrimi Aplikacioneve Zyrtare ne Komune	Janar Dhjetor 2026	Komuna	Lehtësim i proceseve të punës dhe rritje e efikasitetit në menaxhimin e lëndëve, me qëllim përshpejtimin e punës nëpër sektorë.	
4. Strategjia për Qeverisje Elektronike				
e-Kosova	Janar – Dhjetor 2026	Komuna	<b>Administratë efikase</b> Qeverisja elektronike paraqet një mekanizëm institucional për ofrimin e shërbimeve publike nga institucionet qeveritare dhe Lokale , duke shfrytëzuar teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, me qëllim rritjen e efikasitetit, transparencës dhe cilësisë së shërbimeve për qytetarët, bizneset dhe palët e tjera të interesuara.	
5. Të tjera				
Administrimi i ueb-faqes së Komunës dhe intraneti	Janar – Dhjetore 2026		Mirëmbajtja e ueb-faqes së Komunës dhe e Intranetit me qëllim ofrimin e shërbimeve më të afërta për qytetarët.	

## Zyra e Informimit

Planifikimi i aktiviteteve për vitin 2026:

Njësia për Komunikim me Publikun, në kuadër të Planit të Punës për vitin 2026, synon të organizojë dhe të mbështesë një sërë aktiviteteve me qëllim rritjen e transparencës, informimit publik dhe respektimit të afateve ligjore në **Komunën e Kaçanikut**. Në këtë drejtim, do të realizohen këto veprime:

- Publikimi në webfaqen zyrtare i vendimeve të Kryetarit dhe të Kuvendit të Komunës në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës;
- Dërgimi i vendimeve të Kryetarit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) për konfirmimin e ligjshmërisë;
- Publikimi i Planit të Punës së Kryetarit të Komunës së Kaçanikut për vitin 2026;
- Publikimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Kaçanikut për vitin 2026;
- Publikimi i raporteve mujore dhe periodike financiare;
- Publikimi i Raportit Vjetor Financiar për periudhën janar–dhjetor 2025;
- Publikimi, brenda afateve ligjore, i njoftimeve për mbajtjen e konsultimeve publike, takimeve publike, dëgjimeve buxhetore dhe procesit të buxhetimit me pjesëmarrje.

Gjithashtu, Njësia do të sigurojë:

- Publikimin e Planit të Konsultimeve Publike për dokumentet që planifikohet të hartohen gjatë vitit 2026;
- Publikimin e njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete, si dhe të komiteteve jo obligative;
- Publikimin e njoftimeve për mbajtjen e mbledhjeve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
- Publikimin e lajmeve dhe njoftimeve për aktivitetet e Kryetarit të Komunës së Kaçanikut, Drejtorive Komunale dhe Kuvendit të Komunës.

Në kuadër të transparencës dhe llogaridhënies institucionale, Njësia për Komunikim me Publikun do të realizojë edhe këto aktivitete:

- Publikimin në webfaqen zyrtare të rregulloreve, planeve dhe strategjive, pas marrjes së miratimit nga MAPL;
- Pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike;
- Publikimin e Raportit për Qasje në Dokumente Publike;
- Publikimin e Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit;
- Publikimin e Projekt-Buxhetit (KAB-it);

- Publikimin e Buxhetit Final të Komunës së Kaçanikut për vitin 2026;
- Publikimin e Raportit të Performancës Komunale për vitin 2025.

Dokumentet për të cilat duhet të raportohet në Kuvendin e Komunës janë:

- Raporti për zbatimin e Planit të Integritetit;
- Raporti i Performancës Komunale për vitin 2025;
- Raporti për obligimet që rrjedhin nga Agjenda Evropiane;
- Raportimi lidhur me gjetjet dhe rekomandimet e Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Të gjitha dokumentet e hartuara nga Komuna e Kaçanikut, i nënshtrohen procesit të lekturimit profesional dhe përkthehen në gjuhët zyrtare të komunës, përkatësisht në gjuhën serbe. Po ashtu, dokumente të caktuara, përfshirë lajme, njoftime dhe thirrje publike, përkthehen edhe sipas nevojës në gjuhët e komuniteteve në përdorim zyrtar në Komunën e Kaçanikut.

#### **Aktivitetet e planifikuara të realizohen për secilin muaj të vitit 2026:**

<b>1-Janar</b>	
<b>1</b>	Publikimi në webfaqe i vendimeve të kryetarit
<b>2</b>	Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL
<b>3</b>	Publikimi i planit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2026
<b>4</b>	Publikimi i planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026
<b>5</b>	Publikimi i raportit vjetorë i kryetarit për vitin 2025
<b>6</b>	Publikimi i raportit të punës së ZKP-së
<b>7</b>	Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e konsultimeve dhe takimeve publike
<b>8</b>	Publikimi i raportit për organizimin e konsultimeve publike 2026
<b>9</b>	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe KK-së
<b>10</b>	Publikimi i njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKSB-së
<b>11</b>	Publikimi i lajmeve, njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, drejtorëve dhe KK-së

12	Publikimi i rregulloreve-planeve dhe strategjive pas marrjes së miratimit nga MAPL, në webfaqe
13	Publikimi i raportit vjetorë për Qasje në Dokumente Publike 2025
14	Publikimi i raporteve mujore financiare
15	Përkthimi i dokumenteve, lajmeve dhe njoftimeve
16	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Komunitete
17	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komiteteve jo obligative
18	Raporti Financiar Janar-Dhjetor TM-4
<b>2-Shkurt</b>	
1	Publikimi në webfaqe i vendimeve të kryetarit
2	Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL-ë
3	Publikimi i njoftimeve-lajmit për mbajtjen e konsultimeve dhe takimeve publike
4	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe KK-së
5	Publikimi i njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKS-së
6	Publikimi i lajmeve, njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, drejtorëve dhe KK-së
7	Publikimi i rregulloreve-planeve dhe strategjive pas marrjes së miratimit nga MAPL, në webfaqe
8	Publikimi i raporteve mujore financiare
9	Përkthimi i dokumenteve, lajmeve dhe njoftimeve
10	Publikimi i raportit vjetor financiar (Janar-Dhjetor 2026)
11	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Komunitete
12	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komiteteve jo obligative
<b>3-Mars</b>	
1	Publikimi në webfaqe i vendimeve të kryetarit
2	Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL
3	Publikimi i njoftimeve-lajmit për mbajtjen e konsultimeve dhe takimeve publike
4	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe Kuvendit Komunal

5	Publikimi i njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKSB-së
6	Publikimi i lajmeve, njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, drejtorëve dhe zyrës së kuvendit komunal
7	Publikimi i rregulloreve-planeve dhe strategjive pas marrjes së miratimit nga MAPL, në webfaqe
8	Publikimi i raporteve mujore financiare
9	Përkthimi i dokumenteve, lajmeve dhe njoftimeve
10	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Komunitete
11	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komiteteve jo obligative
<b>4-Prill</b>	
1	Publikimi në webfaqe i vendimeve të kryetarit
2	Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL-ë
3	Publikimi i raporteve mujore financiare
4	Publikimi i njoftimeve-lajmit për mbajtjen e konsultimeve dhe takimeve publike
5	Publikimi i raportit 3 mujor financiar TM- 1(Janar-Mars)
6	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe KK-së
7	Publikimi i njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKSB-së
8	Publikimi i lajmeve, njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, drejtorëve dhe KK-së
9	Publikimi i rregulloreve-planeve dhe strategjive pas marrjes së miratimit nga MAPL, në webfaqe
10	Përkthimi i dokumenteve, lajmeve dhe njoftimeve
11	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Komunitete
12	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komiteteve jo obligative
13	Raporti Financiar Janar-Mars-TM-1
<b>5-Maj</b>	
1	Publikimi në webfaqe i vendimeve të kryetarit
2	Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL
3	Publikimi i raporteve mujore financiare

4	Publikimi i njoftimeve-lajmit për mbajtjen e konsultimeve dhe takimeve publike
5	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe Kuvendit Komunal
6	Publikimi i njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKSB-së
7	Publikimi i lajmeve, njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, drejtorëve dhe zyrës së kuvendit komunal
8	Publikimi i rregulloreve-planeve dhe strategjive pas marrjes së miratimit nga MAPL, në webfaqe
9	Përkthimi i dokumenteve, lajmeve dhe njoftimeve
10	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Komunitete
11	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komiteteve jo obligative
<b>6-Qershor</b>	
1	Publikimi në webfaqe i vendimeve të kryetarit
2	Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL
3	Publikimi i njoftimit dhe lajmit për mbajtjen e takimit të parë publik me qytetarë për raportimin për punën 6 mujore të kryetarit të komunës
4	Publikimi i raporteve mujore financiare
5	Publikimi i njoftimeve-lajmit për mbajtjen e konsultimeve dhe takimeve publike
6	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe KK-së
7	Publikimi i njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKSB-së
8	Publikimi i lajmeve, njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, drejtorëve dhe KK-së
9	Publikimi i rregulloreve-planeve dhe strategjive pas miratimit nga MAPL, në webfaqe
10	Publikimi i raportit të punës së kryetarit për 6 mujorin e parë të vitit 2026
11	Publikimi i njoftimit për mbajtjen e konsultimit publik me qytetarë për Projekt Buxhetin e Komunës-KAB-in
12	Publikimi i raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2025
13	Përkthimi i dokumenteve, lajmeve dhe njoftimeve
14	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Komunitete
15	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komiteteve jo obligative

<b>7-Korrik</b>	
1	Publikimi në webfaqe i vendimeve të kryetarit
2	Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL
3	Raporti 6 mujor financiar TM-2 (Janar-Qershor 2026)
4	Publikimi i raporteve mujore financiare
5	Publikimi i njoftimeve-lajmit për mbajtjen e konsultimeve dhe takimeve publike
6	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe KK-së
7	Publikimi i njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKSB-së
8	Publikimi i lajmeve, njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, drejtorëve dhe KK-së
9	Përkthimi i dokumenteve, lajmeve dhe njoftimeve
10	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Komunitete
11	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komiteteve jo obligative
12	Raporti Financiar Janar-Qershor TM-2
<b>8-Gusht</b>	
1	Publikimi në webfaqe i vendimeve të kryetarit
2	Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL-ë
3	Publikimi i planit dhe kalendarit për organizimin e dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit 2025
4	Publikimi i raporteve mujore financiare
5	Publikimi i njoftimeve-lajmit për mbajtjen e konsultimeve dhe takimeve publike
6	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe Kuvendit Komunal
7	Publikimi i njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKSB-së
8	Publikimi i lajmeve, njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, drejtorëve dhe zyrës së kuvendit komunal
9	Publikimi i rregulloreve-planeve dhe strategjive pas marrjes së miratimit nga MAPL, në webfaqe
10	Përkthimi i dokumenteve, lajmeve dhe njoftimeve

11	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Komunitete
12	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komiteteve jo obligative
<b>9-Shtator</b>	
1	Publikimi në webfaqe i vendimeve të kryetarit
2	Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL
3	Publikimi i raporteve mujore financiare
4	Publikimi i njoftimeve-lajmit për mbajtjen e konsultimeve dhe takimeve publike
5	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe KK-së
6	Publikimi i njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKSBS-së
7	Publikimi i lajmeve, njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, drejtorëve dhe zyrës së kuvendit komunal
8	Publikimi i rregulloreve-planeve dhe strategjive pas marrjes së miratimit nga MAPL, në webfaqe
9	Publikimi i raportit të performancës komunale për vitin 2025 (Nëse përgatitet nga MAPL-ja)
10	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Komunitete
11	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komiteteve jo obligative
<b>10-Tetor</b>	
1	Publikimi në webfaqe i vendimeve të kryetarit
2	Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL
3	Publikimi i raporteve mujore financiare
4	Publikimi i raportit 9 mujor financiar TM-3 (Janar-Shtator 2026)
5	Publikimi i njoftimeve-lajmit për mbajtjen e konsultimeve dhe takimeve publike
6	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe Kuvendit Komunal
7	Publikimi i njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKSBS-së
8	Publikimi i lajmeve, njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, drejtorëve dhe zyrës së kuvendit komunal
9	Publikimi i rregulloreve-planeve dhe strategjive pas marrjes së miratimit nga MAPL, në webfaqe

10	Përktimi i dokumenteve, lajmeve dhe njoftimeve
11	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Komunitete
12	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komiteteve jo obligative
	Raporti Financiar Janar-Shtaor TM-3
<b>11-Nëntor</b>	
1	Publikimi në webfaqe i vendimeve të kryetarit
2	Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL
3	Publikimi i njoftimeve-lajmit për mbajtjen e konsultimeve dhe takimeve publike
4	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe Kuvendit Komunal
5	Publikimi i njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKSB-së
6	Publikimi i lajmeve, njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, drejtorëve dhe zyrës së kuvendit komunal
7	Publikimi i rregulloreve-planeve dhe strategjive pas marrjes së miratimit nga MAPL, në webfaqe
8	Përktimi i dokumenteve, lajmeve dhe njoftimeve
9	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Komunitete
10	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komiteteve jo obligative
<b>12-Dhjetor</b>	
1	Publikimi në webfaqe i vendimeve të kryetarit
2	Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL
3	Publikimi i njoftimeve-lajmit për mbajtjen e konsultimeve dhe takimeve publike
4	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe Kuvendit Komunal
5	Publikimi i njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKSB-së
6	Publikimi i lajmeve, njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, drejtorëve dhe zyrës së kuvendit komunal
7	Publikimi i rregulloreve-planeve dhe strategjive pas marrjes së miratimit nga MAPL, në webfaqe

8	Publikimi i raportit për qasje në dokumente publike
9	Publikimi i planit të punës së zyrës për informim për vitin 2026
10	Përkthimi i dokumenteve, lajmeve dhe njoftimeve
11	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Komunitete
12	Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komiteteve jo obligative
13	Publikimi i njoftimit dhe lajmit për mbajtjen e takimit të dytë publik me qytetarë dhe raportimi për punën 1 vjeçare të kryetarit të komunës

### Përfundim:

Plani i Punës i Sektorit për Komunikim me Publikun për Komunën Kaçanikut përfaqëson një dokument strategjik që synon forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe komunikimit të hapur ndërmjet institucioneve komunale dhe qytetarëve. Përmes zbatimit të këtij plani, sektori angazhohet të sigurojë informim të saktë, të drejtë dhe me kohë për të gjitha aktivitetet, vendimet dhe politikat e komunës, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e administratës së hapur.

Zbatimi i aktiviteteve të parapara do të kontribuojë në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve komunale, në përmirësimin e përfshirjes së publikut në proceset vendimmarrëse dhe në garantimin e qasjes së barabartë në informata për të gjitha komunitetet. Njësia për Komunikim me Publikun mbetet e përkushtuar që, përmes profesionalizmit, etikës dhe respektimit të procedurave ligjore, të luajë një rol kyç në avancimin e qeverisjes së mirë dhe në forcimin e imazhit institucional të Komunës së Kaçanikut.

## Zyra për Komunitete dhe Kthim

QËLLIMI : integrimi i personave të kthyer, riatdhesimi i tyre në shoqëri ofrimi i shërbimeve varësisht nga nevoja							
Objektivi	Aktiviteti	Masat	Afati kohor	Tregusi I matjes	Kostoja finaciare	Instucionet e perfshira	Dokumenti I referuar
1. Fuqizimi I kapaciteteve komunale për riintegrim	1.1 Fuqizimi I zyrave , stafit drejtorive komunale varsisht nga nevojat, per trajnime	Rekrutimi dhe plotsimi I stafit varsisht nga nevojat	Janar Dhjetor	Monitorimi i punes dhe aktiviteve	Buxheti komunal	Komuna ZKK DRPR	Strategjia kombëtare për riintegrim Plani I veprimit
2. Bashkëpunimi dhe koordinimi ngusht ndërinstucional në nivel vertical dhe horizontal të insutucioneve te cilave veprojn në Komunë	Bashkëpunimi I ZKKK me gjendjen civile ( QKRC) për paisje me dokumenta personale të personave të riatedhesuar	Referimi I rasteve për regjistrim si dhe pajisja e tyre me dokumente	Janar Dhjetor	Numri I rasteve te referuara dhe te pajisur me dokumente	Buxheti komunal	ZKKK Z.GJ.C	Strategjia kombëtare për riintegrim Plani I veprimit

<p>3. Bashkëpunim per kraheja e ZKKK nga instucionet Komunale dhe ojç vendore dhe ndër kombëtare .</p>	<p>1.2 Bashkëpunimi I ngusht I ZKKK me drejtorin e arsimit për regjistrimin e nxënësve nëper shkolla , nostifikimin e dokumenteve dhe ofrimin e kurseve për fëmijët e riatdhesuar .</p> <p>1.3 bashkëpunimi I ZKKK me zyret Komunale të punsimit, QAP dhe themelimit të bizneseve të personave të riatdhesuar .</p>	<p>Dërgimi I listave nga ZKKK tek DKA</p> <p>Identifikimi I fëmijëve, për kurse</p> <p>Organizimi I kurseve te gjuhes</p> <p>Nostrifikimi I dokumenteve</p> <p>Referimi I personave të riatdhesuar tek zyrat Komunale të punsimit si punëkërkues.</p>	<p>Janar Dhjetor</p> <p>Janar Dhjetor</p>	<p>Nr I fëmijëve të regjistruara, nëpër shkolla , nr. I femijve qe kan perfituar nga kurset e gjuhes dhe mesimi plotsuese</p> <p>Nr I dokumenteve te nostrifikuara</p> <p>Nr I personave të regjistruar</p>	<p>Buxheti komunal</p> <p>Program i rintegrimit</p>	<p>DKA MASHT ZKKK DRPR Donatoret.</p> <p>ZKK ZP QAP Drejetorit komunale</p>	<p>Strategjia kombëtare për riintegrim</p> <p>Plani I veprimit.</p> <p>Strategjia kombëtare për riintegrim</p> <p>Plani I veprimit</p>
--	---	---	---	---	---	---	--

4.Ofrimi I sherbimeve psiko socoale shëndesore .	1.4 Ofrimi I sherbimeve psikosociale dhe shëndetsore	Caktimi I specialistit për sherbime psikosociale familjare nga qendra për mireqenje sociale në rast nevojë.	Janar Dhjetor	Nr I personave të cilët kanë pasur nevojë për sherbime te tilla	Program I rintegrimit	MSH QPS ZKKK DRPR	Strategjia kombëtare për riintegrim Plani I veprimit
Strehimi dhe akomodimi Vetëdijsimi public dhënja e informacionit të persova të riatdhesuar	Banimi I qendrueshem	Sigurimi I banimit me qira dhe akomodimi , pakos ushqimore Renovimit etj	Janar dhjetor	Monitorimi dhe mbikqyrja varësisht nga nevoja dhe nr I rasteve .	Program I riintegrit	ZKK DRPR Etj	Strategjia kombëtare për riintegrim Plani I veprimit
Vetëdijsimi public dhënja e informacionit të persova të riatdhesuar	Informimi I persova te riatdhesuar per te drejtat e tyre sidhe regjistrimi I tyre ne program SRM dhe arkivimi I dokumentacionit dhe monitorimi I rasteve të personave te riatdhesuar .	Informimim , Regjistrimi në program I të dhënave dhe njoftimi I të drejtave dhe varësisht nga nevoja dhe kërkesa Vizita në teren monitorimi I rasteve.	Janar Dhjetor	Monitorimi Vizita ne teren	Ministria donator	ZKK DRPR Donator	Strategjia kombëtare për riintegrim Plani I veprimit

## Zyra për Barazi Gjinore

Aktiviteti	Departamenti të cilit i kërkohet përkrahje/bashkëpunim	Data e fillimit	Data e zbatimit	Burimet e nevojshme (stafi, pajisjet teknike etj.)	Buxheti i nevojshëm	Rezultati i dëshiruar/ i pritshëm	Me cilin Dokumenti Strategjik është në pajtueshmëri aktiviteti në fjalë
1.1 Monitorimi i politikave ekzistuese publike ( i ligjeve, udhëzimeve administrative , rregulloreve ) në aspektin e barazisë gjinore .	ZBGJ, KOMUNA.	Janar	Dhjetor	Monitorimi i tyre	Nuk ka buxhet	Implementimi , zbatimi i tyre	Ligji për barazi gjinore
1.2 Mbajtja e aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe vetë disuese mbi barazinë gjinore me grupin e grave deputete ( fuqizimi në vendimarrje, planifikimi i buxhetit) .	ZBGJ, G.G.A, KOMUNA, OJQ vendore dhe ndërkombëtare	Janar	Dhjetor	Salla, llap topi, projektori	300 €	Pjesëmarrja më e madhe e grave në procesin e vendimë marrjës, buxhetimi i përgjegjshëm gjinor	Ligji për barazi gjinore etj .

1.2 Vazhdimi i masës afirmative për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve,	MAPL, ABGJ ,ZBGJ dhe zyra kadastrit për regjistrim të pronës së paluajtur .	I vazhdueshëm	Prill- me mundësi vazhdimi	Web faqja e komunës, fletë palosje, salla.	Nuk ka buxhet.	Vazhdimi i kësaj mase , dhe pjesëmarrja më e madhe e grave në regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve .	Ligji për barazi gjinore dhe udhëzimi administrativ Strategjia kombëtare për të drejtat pronësore në Kosovë 2016-2020
1.4 Ngritja e kapaciteteve për integrim gjinor në politika publike në nivel lokal .	MAPL, ABGJ, ZBGJ . Komuna, Ojq, vendore dhe ndërkomëbtare .	I vazhdueshëm			300 €	Instuticionet në përgjithësi në nivel komunal	Ligji për barazi gjinore
1.5 Ngritja e pjesëmarrjes se grave në debate dhe dëgjime publike.	G.G.A Koordinatori i performancës dhe Zyra e informimit	I vazhdueshëm		Salla, proejktori lap top web faqja e komunës.	100 €	Gra pjesmarrëse në degjime dhe debate publike.	Nevojë e Komunës
1.6 Sensibilizimi i grave për mundësitë e përfitimit nga Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural si dhe pjesëmarrja e grave fermerë ne shërbime këshillues.	Drejtorja e bujqësisë	I vazhdueshëm		Fletëpalosje Informuese,web faqja e Komunës, ofrimi I shërbimeve kshilluese per grante dhe subvencione	100€	Gra te pajisura me njohuri për mundësit e përfitimit nga grantet ne bujqësi .	SKZH: Masa 16: Rritja e Qasjes në Financa për Ndërmarrjet Kosovare Ndërmarrjet

Aktiviteti	Departamenti të cilit i kërkohet përkrahje/bashkëpunim	Data e fillimit	Data e zbatimit	Burimet e nevojshme (stafi, pajisjet teknike etj.)	Buxheti i nevojshëm	Rezultati i dëshiruar/ i pritshëm	Me cilin dokumenti Strategjik është në pajtueshmëri aktiviteti në fjalë
1.7 Takimet e rregullta në këshillin lokal të sigurisë në bashkësi	Të gjitha institucionet të cilat veprojnë në komunën tonë.	I vazhdueshëm.			Nuk ka kosto buxhetore		Në bazë të udhëzimit administrativ për formimin e KKSB- së.
1.8 Organizimi i fushatave vetëdijësuese për të drejtën në trashëgimi dhe pronë. 2 tryeza të rrumbullakta	Zbgj ,Zyra e kadastrit dhe Noteret	Janar	Dhjetor	Salla , lloptopë projektori	200 €	Rritja e numrit të raseve të regjistruara si pronare dhe bashkpronare	SKZH: Masa 13: forcimi i sistemit, Strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore në osovë 2016-2020
QËLLIMI : : Promovimi i vlerave gjinore dhe luftimi i stereotipeve gjinore.							
Aktiviteti	Departamenti të cilit i kërkohet përkrahje/bashkëpunim	Data e fillimit	Data e përfundimit	Burimet e nevojshme (stafi, pajisjet teknike etj.)	Buxheti i nevojshëm	Rezultati i dëshiruar/ i pritshëm	Me cilin Dokumenti Strategjik është në pajtueshmëri aktiviteti në fjalë

<p>Shënimi i 8 marsit (dita e gruas )</p> <p>Ne te gjitha shkollat e komunes 1 ore do te mbahet , me temen</p> <p>Roli I gruas ne shoqerin kosovare nder vite .</p>	<p>ZBGJ, KOMUNA</p> <p>Drejtoria e Arsimit</p>	Mars	Mars	Salla projektori llaptopi	100 €	Vetdisimi I nxeneseve neper shkolla .	Globale
<p>Shënimi Muajit tetor fushata vetëdisuese trafikimi me qenije njerëzore.</p>	<p>ZBGJ SH.P.K</p> <p>Drejtoria arsmit</p>	Tetor	Tetor	Shkollat llaptopi ,projektor ,salla dhe fletpalosje.	200 €	Nxënësit e shkollave të mesëme të ulëta	
<p>Fushata vetdisuese – kundër kancerit të gjirit – Muaji rozë .</p>	<p>ZBGJ. DSHMS, QKMF, Web faqja e komunës .</p>	Tetor	Tetor	Salla,projektor llaptop.	100 €.	Gra dhe vajza të vetedijësuar kundër- kancerit të gjirit.	Globale

Shënimi i 25 Nentorit deri 10 Dhejtor (16 Aktivizem kundër dhunës në baza gjinore) Fushata vetëdisuese kundër dhunës në familje.	Mekanizmi kundër dhunës në familje Web faja e komunës. Këshili bashkësis islame Kaçanik	Nëntor.	Dhjetor .	Salla projektori llaptopi .	400 €.	Gra, burra nxënësia etj	Globale
Ndërmarrja e masave afirmative për sigurimin e pjesëmarrjes së barabartë në pozitë vendimëmarre	ZBGJ	Vazhdimësi			Nuk ka kosto buxhetore	Rritja e gjinis femrore në pozitë vendimëmarre	Ligji për barazi gjinore etj
Hulumtimi për përkatësin gjinore dhe punësimi në sektorin publik dhe privat	ZBGJ Zyra e punësimit dhe zyra rajonale e punësimit privat .	Vazhdimësi			Nuk ka kosto buxhetore	Mbledhja e të dhënave dhe statistikave në baza gjinore .	Ligji për barazi gjinore etj
Takimet e rregullta me anëtarët e mekanizmit kundër dhunës në familje	ZBGJ si dhe gjithë akëterët instucional të cilët janë pjesë e tij	Janar	Dhjetor		200 €	Pjesëmarrja e akterëve te mekanizmit dhe zbatimi i planit të tij	Strategjia kombëtare kundër dhunës ne familje – konventa e Stambollit

# Zyra për Integritime Evropiane

## 1. Hyrje

Integrimi Evropian përbën një prioritet strategjik për Republikën e Kosovës dhe institucionet e saj lokale. Komuna e Kaçanikut, përmes këtij Plani Pune për vitin 2026, synon të kontribuojë aktivisht në procesin e Integritimit Evropian duke përmirësuar qeverisjen lokale, harmonizimin e politikave komunale me standardet e Bashkimit Evropian dhe rritjen e përfitimeve për qytetarët nga programet e BE-së.

---

## 2. Qëllimi i Planit

Qëllimi i këtij plani është forcimi i kapaciteteve institucionale të Komunës së Kaçanikut për zbatimin e prioriteteve të Integritimit Evropian, në përputhje me Planin Kombëtar për Integritime Evropiane (PKIE) dhe Agjendën Evropiane për Kosovën rritjes së transparencës, përmirësimit të shërbimeve publike dhe përfitimit nga fondet e Bashkimit Evropian.

---

## 3. Objektivat Specifike

1. Harmonizimi i akteve komunale me legjislacionin dhe standardet e BE-së,
2. Ngritja e kapaciteteve administrative për Integritime Evropiane,
3. Forcimi i bashkëpunimit me institucionet qendrore dhe donatorët e BE-së,
4. Rritja e transparencës dhe informimit të qytetarëve për procesin e Integritimeve Evropiane,
5. Rritja e pjesëmarrjes së Komunës së Kaçanikut në programe dhe fonde të BE-së (IPA, Erasmus+ etj.)

#### **4. Plani i aktiviteteve kryesore për vitin 2026**

**Objektivi 1:** Harmonizimi i Politikave dhe Akteve Komunale,

**Objektivi 2:** Ngritja e Kapaciteteve Administrative,

**Objektivi 3:** Bashkëpunimi Institucional dhe Ndërkombëtar,

**Objektivi 4:** Informimi dhe Përfshirja e Qytetarëve,

**Objektivi 5:** Projekte dhe Fonde të Bashkimit Evropian.

---

#### **5. Monitorimi dhe Raportimi**

- Raportim gjashtëmuor dhe vjetor mbi realizimin e planit,
  - Prezantim i raporteve para Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit Komunal,
  - Vlerësim i progresit bazuar në tregues të matshëm.
- 

#### **6. Burimet**

- Burime njerëzore: Stafi i Komunës së Kaçanikut,
- Burime financiare: Buxheti komunal dhe fondet e donatorëve,
- Mbështetje teknike: Institucionet qendrore dhe partnerët e BE-së.

## ARSYETIM

Plani i Punës për Integritime Evropiane për Komunën e Kaçanikut për vitin 2026 është përpiluar në nivel strategjik dhe përmbljedhës, me qëllim që të shërbejë si dokument orientues për veprimtarinë e komunës në procesin e Integritimit Evropian.

Hartimi i planit vetëm në pikat kryesore është bërë për arsyet në vijim:

- I. Përputhshmëri me dokumentet strategjike qendrore, përfshirë Planin Kombëtar për Integritime Evropiane, duke ruajtur fleksibilitet në zbatim sipas zhvillimeve gjatë vitit 2026.
- II. Lehtësim i koordinimit ndërinstitucional, pasi një plan i përmbljedhur mundëson përfshirjen e të gjitha drejtorive komunale pa kufizime operative.
- III. Përshtatje me kapacitetet administrative dhe buxhetore të komunës, duke lënë hapësirë që aktivitetet e detajuara të planifikohen përmes planeve operative vjetore.
- IV. Rritje e efikasitetit në monitorim dhe raportim, duke u fokusuar në objektiva dhe aktivitete kyçe të matshme.
- V. Mundësi për përditësim dhe plotësim gjatë vitit, në varësi të thirrjeve për fonde të BE-së dhe prioriteteve të reja institucionale.

Në këtë mënyrë, plani paraqet një kornizë të qartë veprimi, pa hyrë në detaje operative, të cilat do të specifikohen përmes dokumenteve zbatuese dhe vendimeve përkatëse të komunës.

## Zyra e Kuvendit Komunal


Spektori i Kuvendit është i formuar me akte të Kuvendit të Komunes, funksionon në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunes. Punët dhe detyrat e punës në Sektorin e Kuvendit kryhen nga zyrtari i kuvendit (1) i punësuar në këtë sektor, ndihmuar nga asistentja e Kryesuesit të KK.

Objektivat e Sektorit të Kuvendit:

1. Angazhim në përgatitjen e Planit të punës së Kuvendit të Komunes për vitin 2026 në cilësi të anëtares së komisionit;
2. Përgatitjet e nevojshme për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunes dhe të trupave punuese të Kuvendit të Komunes, në bazë të planit të tyre të punës dhe distribuimi i tyre;
3. Mbajtja dhe përpilimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kuvendit të Komunes dhe trupave punuese të kuvendit, prezantimi i tyre për shqyrtim në mbledhje të KK dhe të trupave punuese të KK;
4. Përpilimin të gjitha akteve (vendime e rregullore) dhe shkresave të tjera që dalin nga mbledhjet e Kuvendit dhe trupave punuese të KK, në bazë të propozim vendimeve, respektivisht propozim rregulloreve;
5. Pranimin e çdo lënde që adresohet në emër të Kuvendit të Komunes apo komiteteve të kuvendit dhe zhvillimin e procedurave të mëtutjeshme;
6. Dërgimin e akteve të KK për përkthim tek zyrtari përkatës, zyrtari për përkthime;
7. Dërgimin e të gjitha vendimeve të Kuvendit të Komunes, në afatin e përcaktuar ligjor, Zyrës Ligjore të MAPL me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së tyre;
8. Dërgimin e të gjitha akteve dhe dokumentet tjera të Kuvendit të Komunes, në afatin e përcaktuar ligjor, Zyrës për Informim respektivisht Zyrës së IT, me qëllim të publikimit të tyre në faqen zyrtare të komunes;
9. Përgatitja e Informatës për Aktivitetin e Kuvendit të Komunes për vitin 2026 (në bashkëpunim me kryesuesin e KK);
10. Përgatitja e Raportit të punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2026 (në bashkëpunim me kryesuesin e KK);
11. Plotësimin e çdo Pyetëtori për vitin 2026 (tremujor, gjashtëmujor, nëntëmujor dhe vjetor) që kërkohet nga MAPL me të dhënat lidhur me aktivitetin e Kuvendit të Komunes dhe të trupave punuese të KK;
12. Përpilimin e çdo Shkresë tjetër në emër të Kryesuesit të Kuvendit të Komunes, sipas kërkesave dhe nevojave që paraqitën;
13. Punë të tjera teknike dhe administrative sipas kërkesave dhe nevojave që paraqitën, që janë në kompetenca të sektorit të kuvendit.

# Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

## Struktura organizative e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme



## Hyrje

Plani Vjetor i Punës i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme për vitin 2026 paraqet kornizën strategjike dhe operative për organizimin, koordinimin dhe zhvillimin e veprimtarisë administrative të Komunës. Ky plan hartohet në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, Statutin e Komunës dhe aktet nënligjore përkatëse, duke synuar funksionimin e rregullt, transparent dhe efikas të administratës komunale.

Drejtorja e Administratës së Përgjithshme është organi përgjegjës për organizimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve administrative të Komunës, duke përfshirë mbështetjen administrative të Kuvendit, Kryetarit të Komunës dhe strukturave ekzekutive, si dhe koordinimin e sektorëve dhe shërbimeve që ofrojnë këto struktura. Në veprimtarinë e saj, Drejtorja e Administratës së Përgjithshme mbikëqyr sektorin e Ofiqarisë dhe të gjitha shërbimet që ky sektor ushtron, në përputhje me legjislacionin në fuqi, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Po ashtu, Drejtorja siguron funksionimin e rregullt dhe efikas të Zyrës Pritëse dhe të Arkivit Komunal, duke garantuar pranimin, administrimin, regjistrimin dhe arkivimin e dokumentacionit zyrtar në përputhje të plotë me procedurat ligjore. Në kuadër të përgjegjësisë së saj, Drejtorja menaxhon shërbimet logjistike dhe teknologjike të Komunës, përfshirë transportin, depon, shërbimin postar, inventarin, sigurinë, përkthimin e dokumenteve zyrtare, si dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe pajisjeve të teknologjisë së informacionit. Njëkohësisht, Drejtorja planifikon dhe zbaton proceset e digjitalizimit dhe inovacionit teknologjik duke synuar modernizimin e procedurave administrative, digjitalizimin dhe automatizimin e proceseve të punës dhe rritjen e efikasitetit institucional.

Gjithashtu, Drejtorja ka përgjegjësi për ofrimin e shërbimeve administrative ndaj qytetarëve dhe institucioneve, përmirësimin e qasjes dhe transparencës në shërbimin civil, mirëmbajtjen dhe përditësimin e web-faqes komunale, si dhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe promovimin e standardeve të larta etike në administratë. Drejtorja ofron gjithashtu këshilla dhe mbështetje profesionale për drejtoritë dhe strukturat tjera komunale mbi çështjet administrative dhe kryen çdo detyrë tjetër të caktuar nga Kryetari i Komunës dhe të përcaktuar me ligj.

Ky plan vjetor synon të harmonizojë veprimtarinë e Drejtorisë me prioritetet strategjike të Komunës, të rrisë efikasitetin e shërbimeve administrative, të modernizojë proceset operative përmes digjitalizimit dhe të sigurojë një administratë të besueshme, të qasshme dhe të orientuar drejtë qytetarëve.

Sektorët, Zyrat dhe Zyrtarët	Aktivitetet e Planifikuara.	Rezultatet e pritshme nga aktivitetet e zhvilluara.	Njësitë institucionale zbatuese.	Realizimi	
				Koha	Vendi
<b>1. Bashkëpunimin dhe organizimin e punës në Qendrën për Shërbime me Qytetar</b>					
<b>Sektori i QSHQ</b>	1.1 Ofrimi i shërbimeve efikase dhe në kohë në mënyrë të vazhdueshme.	Ngritja e besueshmërisë dhe transparencës ndaj qytetarëve.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme	Janar- dhjetor 2026.	Komunë.
	1.2 Përcjellja e punës dhe aktiviteteve të zyrtarëve të QSHQ-së.	Punë më efikase dhe rezultatet me te mira duke respektuar ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme	Janar- dhjetor 2026.	Komunë.
	1.3 Adresimi me kohë i të gjitha kërkesave që iu drejtohen Administratës Komunale dhe Kuvendit Komunal.	Sistemimi i të gjitha kërkesave nga qytetarët, procedimi në drejtoritë përkatëse, shqyrtimi i tyre dhe dhënia e përgjigjeve të palëve.	Zyra e Kryetarit dhe të gjitha drejtoritë komunale.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë.
	1.4 Sjellja e mirë ndaj palëve, dhënia e udhëzimeve dhe informimi i tyre.	Rritje e besueshmërisë të qytetarët.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë.
	1.5 Aplikimi i shërbimit “One Stop Shop”, procedimi i kërkesave përmes Intranetit.	Bashkëpunim të mirë me Zyrën e Kryetarit dhe me të gjitha Drejtoritë Komunale me qëllim të procesimit sa më të mirë të lëndëve në Intranet.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë.
	1.6 Informimi i qytetarëve dhe ofrimi i shërbimeve sa më cilësore dhe të përmirësuara.	Realizimi sa më efikas dhe efektiv i shërbimeve në raport me qytetarët.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë.

1.7 Shërbimet e ofruara evidentohen në mënyrë të njësuar përmes librit unik të protokollit.	Realizimi sa më efikas dhe efektiv i shërbimeve në raport me njësitë përgjegjëse në Komunë.	Zyra e Kryetarit, drejtoritë komunale dhe njësitë përgjegjëse.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë.
1.8 Përditësimi dhe pasurimi i webfaqes së Komunës me informacionet që kanë të bëjnë me shërbimet komunale në QSHQ.	Ankesa përmes webfaqes së Komunës, informacionet e nevojshme për shërbimet e ndryshme që ofrohen.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme dhe Zyra për informim.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë.
1.9 Pajisja me inventar të nevojshëm dhe pajisje të IT.	Pajisja me inventar të nevojshëm, posaçërisht me skaner me qëllim që të mos ketë pengesë në skanimin e lëndëve.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë.
2. Sigurimin e një vendi të veçantë për ruajtjen e librave të protokollit, librave unik etj.	Sigurimin e një vendi të veçantë për ruajtjen e librave ashtu siç është paraparë me ligj.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë.
2.1 Kutia ankesave e vendosur në katin përdhësë (për ankesa, sugjerime, kritika, lavdata)	Komisioni për hapjen e kutive të ankesave raporton për çdo ankesë lidhur me shërbimet në QSHQ dhe në përgjithësi, si dhe informon në kohë Drejtoreshën e DAP-it.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë.
<b>2. Bashkëpunimin dhe organizimin e punës në Gjendjen Civile</b>				
2.1 Përcjelljen e punës dhe të aktiviteteve të zyrtarëve të Gjendjes Civile	Punë më efikase dhe rezultate edhe më të mira, duke respektuar ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë dhe zyre të vendit.

<b>Sektori i Gjendjes Civile</b>	2.2 Bashkëpunim shumë të ngushtë me ministrinë përkatëse siç janë: MPB, MAP, MAPL si dhe departamenteve që operojnë në këto ministri.	Bashkëpunim të mirë me ministrinë e përmendura e sidomos me MAPL konkretisht me Departamentin e TI, lidhur me përmirësimin e programimeve në Gjendjen Civile.	MPB,MAP dhe MAPL.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë.	
	2.3 Raportimi i të gjithë punës së Gjendjes Civile në Komunën e Kaçanikut.	Raportet do të jenë të rregullta dhe të sakta që pasqyrojnë punën reale të këtij shërbimi.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë dhe zyre të vendit.	
	<b>3.Përcjellja dhe zbatimi i ligjeve në fuqi dhe ligjeve të reja</b>					
	3.1 Aplikimi i të gjitha dispozitave ligjore që dalin nga Kuvendi i Kosovës	Do të zbatojmë të gjitha ligjet dhe Udhëzimet Administrative që janë në fuqi në Republikën e Kosovës.	MPB dhe Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë dhe zyre të vendit.	
	3.2 Vizita më të shpeshta në teren në Zyrat e Gjendjes Civile, si dhe organizimi për mbylljen e zyrave në teren dhe transferimin e tyre në Gjendjen Civile në Kaçanik	Qëllimi i vizitave në zyrat e Gjendjes Civile në teren do të jetë që koordinimi të jetë më i mirë dhe zbatimi i dispozitave ligjore të jetë më i lehtë, si dhe organizimi për mbylljen e tyre për shkak të kushteve më të mira për shërbimin e palëve.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme, Kuvendi Komunal Kryetari.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë dhe zyre të vendit.	
	3.3 Përcjellja e të gjitha ligjeve dhe udhëzimeve të reja zyrtarëve të Gjendjes Civile.	Përcjellja e njoftimeve dhe informatave tek zyrtarët e Gjendjes Civile do të bëhet me kohë.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë dhe zyre të vendit.	

4.Punët teknike brenda zyrave të Gjendjes Civile					
	4.1 Pajisja me inventar të nevojshëm	Sigurimi i inventarit të nevojshëm dhe arkave metalike për ruajtjen e dokumenteve në të gjitha zyret e Gjendjes Civile.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë dhe zyre të vendit.
	4.2 Sigurimin e një vendi të veçantë për ruajtjen e librave	Sigurimin e një vendi të veçantë për ruajtjen e librave kopje ashtu siç është paraparë me ligj.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë.
5.Zbatimi i kompetencave dhe autorizimeve					
	5.1 Regjistrimet e lindjeve, martesave dhe vdekjes si dhe ruajtja e Akteve.	Regjistrimet e lindjeve, martesave, vdekjeve dhe të shtetësisë në sistem të Gjendjes Civile.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë.
	5.2 Lëshimi i Certifikatave-dokumenteve, deklarimi i adresave zyrtare nga E-Kosova dhe zyra e deklarimit të adresave.	Lëshimi i të gjitha dokumenteve që janë në mandat dhe në kompetencë në afat sa më shkurtë dhe me fleksibilitet.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë.
	5.3 Marrja e vendimeve të ndryshme.	Angazhim në marrjen e vendimeve të ndryshme lidhur me procedurat e regjistrimeve të mëvonshme përmirësimet, ndryshimet etj.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë.

	5.4 Mirëmbajtjen e librave bazë dhe Akteve.	Mirëmbajtjen e akteve të lindjeve, martesave, vdekjeve dhe shtetësisë si dhe mbylljen e tyre në fund të vitit kalendarik.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë.
<b>6.Instalimi i programeve te reja</b>					
	6.1Unifikimin dhe instalimin e programeve te reja.	Instalimin dhe unifikimin e programeve të reja në të gjitha Zyret e Gjendjes Civile.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme dhe MPB/ARC.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë dhe zyre të vendit.
<b>7.Angazhim me i shtuar dhe efikasitet në punë</b>					
	7.1 Angazhim i veçantë në shtimin e efikasitetit të punës.	Forcimi i angazhimit institucional në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, veçanërisht gjatë gjysmës së vitit dhe në fund të vitit, në prag të pushimeve të bashkatdhetarëve.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë dhe zyre të vendit.
	7.2 Furnizim me kohë me material shpenzues.	Furnizimin me kohë me material shpenzues si: Certifikata apo me mjete të tjera të nevojshme për zyret e Gjendjes Civile.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë dhe zyre të vendit.
<b>8.Komunikimi dhe informimi</b>					
	8.1 Ofrimi i informatave të duhura për qytetarët.	Komunikimi me qytetarë në mënyrë korrekte dhe transparente dhe përgjigje me kohë shkresave të tyre.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë dhe zyre të vendit.
<b>9.Koordinimin dhe organizimi i punës në Arkivin Komunal</b>					
	9.1 Ruajtja, mirëmbajtja dhe sistemimi i lëndëve arkivore.	Ruajtja dhe mbrojtja e lëndëve arkivore.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme, Arkivi i Kosovës.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë.

Sektori i Arkivit	9.2 Shqyrtimi në kohë i kërkesave të qytetarëve duke ofruar udhëzime profesionale konform “Ligjit për Arkivat” dhe “Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare të Republikës së Kosovës”.	Përmirësimi i efikasitetit të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe rritja e transparencës.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë.
	9.3 Ofrimi i shërbimeve të arkivit të Komunës për qytetarët si dhe arkivimi elektronik i lëndëve.	Kursimi i hapësirës fizike në objekt dhe qasje më e shpejtë, transparencë e plotë, ruajtje e sigurtë e të dhënave.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë.
	9.4 Realizimi i asgjësimit të materialit të pavlefshëm të arkivuar, në përputhje me procedurat ligjore.	Rritja e efikasitetit dhe funksionalitetit të arkivës përmes organizimit sistematik të dokumenteve dhe respektimit të procedurave ligjore.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë.
	9.5 Furnizim me material të nevojshëm për ruajtjen e dokumenteve zyrtare.	Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve administrative dhe sigurimi i vazhdimësisë së punës.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë.
	9.6 Mbrojtja e lëndës arkivore jashtë Arkivit.	Kontrollimi i dokumentacionit dhe regjistraturës në Komunën e Kaçanikut dhe vizita punuese në shkolla për ofrimin e udhëzimeve profesionale mbi mirëmbajtjen e rregullt të dokumenteve.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë dhe terren.

<b>10. Organizimin e punës në sektorin teknik</b>						
Sektori i punëve të përbashkëta	10.1 Mirëmbajtja e pastërtisë dhe gjendjes teknike të objekteve të administratës komunale.	Nivel më i lartë i pastërtisë dhe gjendjes teknike të objekteve të Administratës Komunale.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë.	
	10.2 Mirëmbajtja e oborrit të objektit si dhe largimi i mbetjeve të panevojshme nga depoja.	Përmirësimi i pamjes së jashtme dhe lirimi i hapësirës në depo.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë.	
	<b>11. Organizimin e punës në sektorin e logjistikës</b>					
	11.1 Pranimi dhe dorëzimi i të gjitha faturave për të gjithë sektorët.	Shërbime, futja në sistemin e faturimit etj.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë.	
	11.2 Qasja në FreeBalance -përpunimi i faturave për të gjithë sektorët e Komunës.	Punimi i gjitha lëndëve nga prokurimi.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë.	
	11.3 Mirëmbajtja e autoparkut dhe veturave zyrtare.	Shërbime efikase dhe ulje të shpenzimeve për vetura zyrtare.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme	Janar- dhjetor 2026.	Komunë.	
	11.4 Qasja në sistemin e E-pasurisë.	Shërbime, regjistrimi dhe barkodimi i aseteve.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.		Komunë.	

<b>12. Bashkërendimi i punës me njësinë e përkthimit</b>					
	12.1 Përkthimi i të gjitha dokumenteve që dalin nga Komuna dhe Kuvendi i Komunës, nga gjuha shqipe në gjuhën serbe.	Plotësimi i kriterëve të Ligjit për Gjuhët Zyrtare në Administratën Komunale.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme dhe Drejtoritë tjera.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë dhe terren.
<b>13. Takimet me këshillat lokal</b>					
	13.1 Organizimi i takimeve me kryetarët e këshillave lokal .	Takime të rregullta me këshillat lokal sipas Udhëzimit Administrativ NR.02/2019 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.	Janar- dhjetor 2026.	Komunë.

## Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

### PLANI PËR MENAXHIMIN E QKMF-së për vitin 2026

Aktivitetit i planifikuar	Koha dhe vendi i implementimit të aktiviteteve		Rezultatet e pritura nga aktivitetet e zhvilluara	Partnerët implementues të aktiviteteve
	Koha	Vendi		
<b>1. Funkionimi i shërbimeve primare shëndetësore</b>				
1.Respektimi i orarit të punës dhe isiplina në punë. 2.Ti kushtohet rëndësi mbajtjes së higjienës në të gjitha objektet shëndetësore. 3.Të sigurohet që puna të jetë efektive,si dhe bashkëpunimi kolegjial te jetë në nivel dhe që do të ishte në interes të pacientit.	Janar – Dhjetor 2026	DSHMS, QKMF, QMF,AMF		Kryetari i Komunës,DSHMS-ja,Ministria e Shëndetësisë.
4.Të vazhdohet me aktivitetet të zhvillimit të vazhdueshëm profesional për mjek dhe infermiere.	Janar – Dhjetor 2026	QKMF, QMF, AMF	Efikasitet në shërbime shëndetësore	DSHMS Ministrija e Shëndetësisë ,OJQ
5.Të vazhdohet me parandalimin e sëmundjeve përmes skriningut.	Janar- Dhjetor 2026			QKMF,DSHMS,Ministria e Shëndetësisë

<p>6.Projekti për vetëdijesimin e te rinjve për sëmundjen e Hiv-Aids-it,si dhe ruajtjen nga sëmundjet seksualisht transmissive.</p> <p>7.Funksionalizimi i sistemit informativ shëndetësor në terren(QMF dhe AMF)</p> <p>8.Vazhdimi i këshillimit me nëna ,gra shtatzëna, si dhe gra te reja lidhur me të gjitha aspektet e shëndetit reprodaktiv si dhe planifikimin familjar.</p>				
<p>9.Trajnimi i stafit për emergjenca mjekësore nga ekspert të Mjekësisë emergjente,</p> <p>10.Të bëhet edukimi i pacientëve lidhur me ndryshimin e stilit te jetës sic jane:obesiteti,duhani drogat,aktivitetet fizike me cka do të behej parandalimi i shumë sëmundjeve që mund ta rrezikonin seriozisht shëndetin.</p> <p>11.Të thellohet bashkëpunimi me komunat tjera ,në menyrë që të bëhet shkëmbimi i përvojave.</p>	<p>Janar – Dhjetor 2026</p>	<p>QKMF, QMF, AMF</p>		<p>QKMF</p>

<p>12.Bashkëpunimi me Kryetarin e Komunës, DSHMS-në dhe Ministrinë e Shendetesise.</p>				
<p>13.Mundësia e lidhjes së kontratës së veçantë me specialist të endokrinologjisë dhe mjekësisë interne, si dhe vazhdimi i kontratave për specialistë të gjinekologjisë,pulmologjisë,radiologjisë dhe atë me të vetmin qëllim që këto shërbime ti ofrohen qytetarëve .14.Mbulimi i terrenit me mjek dhe funksionimi i rregullt i QMF-ve dhe AMF-ve.</p> <p>15.Kodi veshjes për personel shëndetësor ,si dhe stafin tjetër ndihmës.</p> <p>16.Të vazhdohet kujdesi shtëpiak për të sëmurët me kancer dhe pacientët e palevizshëm.</p> <p>17.Të bëhet dezinfektimi,dezinfektimi dhe deratizimi i objekteve shendetesore,si dhe sipas mundësive dezinfektimi,dezinfektimi i hapësirës ajrore të Komunës së Kaçanikut pasi që nuk është bërë asnjëherë që nga përfundimi i luftës.</p>	<p>Janar – Dhjetor 2026</p>	<p>QKMF</p>	<p>Kujdese stabile shëndetësore</p>	<p>DSHMS,QKMF</p>

<p>18.Të vazhdohet me programin per vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë nga mosha 0-3 vjeç.</p> <p>19.Furnizimi me barna nga lista esenciale,si dhe intervenimi i komunës në situata kur nuk kemi furnizim nga Ministria e Shendetesise.</p> <p>20. Faza e tretë e bashkëpunimit QKMF-AQH ,menagjimi i sigurimit të cilësisë dhe akreditimi i institucionit.</p>	<p>Janar – Dhjetor 2026</p>	<p>QKMF, QMF, AMF</p>	<p>Qëndrueshmëri ne furnizim me barna esenciale</p> <p>QKMF- DSHMS- Ministria e Shëndetësisë- AQH</p>	<p>Drejtoria e Shëndetësisë</p> <p>Ministria e Shëndetësisë ,UNICEFI,AMC-ja,Qeveria e Luksemburgut.</p>
<p>21.Respektimi i ligjit për duhanin.</p>	<p>Janar – Dhjetor 2026</p>	<p>QKMF, QMF, AMF</p>		<p>Ministria e Shëndetësisë ,Inspektorati shëndetësor</p>
<p>22.Vazhdimin e bashkëpunimit me organizata qeveritare,joqeveritare të vendit dhe ndërkombëtare.</p>	<p>Janar – Dhjetor 2026</p>	<p>QKMF, QMF, AMF</p>	<p>Ngritja e nivelit te shërbimeve mjekësore</p>	<p>DSHMS,</p> <p>Ministria e Shëndetësisë</p>
<p>23.Të mbahen ligjerata nëpër shkolla me nxënës, për sëmundje te ndryshme, si dhe të bëhen kontrollat sistematike mjekësore për nxënës të shkollës fillore.</p>	<p>Janar – Dhjetor 2026</p>	<p>QKMF, QF, AMF</p>	<p>Njoftimi dhe parandalimi i sëmundjeve ngjitëse</p>	<p>Ministria e Shëndetësisë</p> <p>DSHMS,IKSHP</p>

24. Të punohet sipas protokoleve dhe udhërrefyesve klinik sipas Mjekesise së bazuar në dëshmi	Janar – Dhjetor 2026	QKMF, QMF, AMF		Instituti kombëtar për Shëndetësi Publike Inspektorati sanitar
25. Klasat për nëna dhe fëmijë të vazhdojnë aktivitetin e tyre	Janar- Dhjetor 2026		QKMF- DSHMS-MSH- AMC	
26. Mirëmbajtja e pajisjeve elektroenergjetike në QKMF.	Janar- Dhjetor 2026			
27. Servisimi i rregullt dhe mirëmbajtja e autoambulancave dhe veturave tjera në QKMF	Janar – Dhjetor 2026		QKMF-DSHMS	
28. Të vazhdohet me implementimin e projektit për zvogëlimin e përshkrimit të antibiotikëve në kujdesin primar shëndetësor.	Janar- Dhjetor 2026		QKMF-ICARS- MSH	
29. Dërgimi i mjekëve në specializim sipas UA 04/2020 për Kujdesin Primar Shëndetësor	Janar- Dhjetor 2026		KOMUNA KAÇANIK- MSH	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
30. Fillimi i ofrimit të shërbimit të ultrazërit të abdomenit për qytetarët tanë pas trajnimit të suksesshëm të 4 specialistëve të mjekësisë familjare	Janar- Dhjetor 2026		Komuna Kaçanik, DSHM	
31. Projekti për intervenimin në fëmijërinë e hershme nga mosha 0- 6 vjeç	Janar- Dhjetor 2026		S-ja, QKMF- ja QPS-ja	MSH, MA, MPMS-ja

**PLANIFIKIMI DHE IMPLEMENTIMI I PLANIT TË PUNËS SË QENDRËS PËR PUNË SOCIALE NË  
KAÇANIK PËR VITIN 2026**

OBJEKTIVAT	VEPRIMET	AFATI KOHORË	KOSTOJA FINANCIARE	PËRGJEGJËSIA	REZULTATET	VËSHIRËSITË
<b>ASISTENCA SOCIALE</b>						
1.Përkrahja financiare familjeve në gjendje të rëndë ekonomike, të cilat i plotësojnë kriteret dhe kushtet që i parasheh Ligji Nr.2003/2015 për skemën e ndihmave sociale, si dhe zbatimi në përpikëri i Udhëzimit Administrativ Nr.02/210	Identifikimi dhe përzgjedhja e familjeve të varfra në komunën e Kaçanikut nga nëpunësit social të QPS-së	I përhershëm		Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, departamenti i mirëqenies sociale, DSHMS, QPS	Fokusimi në grupet e cenuara duke i eliminuara të gjitha familjet e papërzgjedhshme në SNS, duke minimizuar gjendjen e rëndë sociale dhe përmirësimin e gjendjes të familjeve në nevojë	Raste të abuzimeve apo tentimeve për përfitim të padrejtë nga skema e ndihmave sociale
2.Monitorimi i zyrtarëve dhe shfrytëzuesve të SNS-së , duke i kontrolluar dhe inspektuar në teren nga komisioni i autorizuar nga QPS-ja	Mbikëqyrja dhe respektimi i afatit ligjor për rastet që kanë kërkuar asistencë sociale , si dhe monitorim më i mirë i rasteve sociale	I përhershëm		Drejtori i QPS-së, Udhëheqësi i Sekës së Asistencës Sociale,nëpunësit e SAS-it dhe shërbimi administrativ	Azhuriteti më i mirë i kërkesave të palëve, respektimi i afateve ligjore	

3.Bashkëpunimi me organet lokale, komunitetin, institucionet tjera relevante, OJQ-të lokale, ndërkombëtare si dhe donatorët e ndryshëm	Do të ketë iniciativa nga ana jonë për takime në nivel komunal me OJQ-të dhe donatorët e ndryshëm me qëllim të ofrimit të ndihmave shtesë të rasteve të rënda sociale	I përhershëm		Drejtori i QPS-së, Udhëheqësi i Sekës së Asistencës Sociale, institucionet relevante, OJQ-të, donatorët etj.	Ofrimi i ndihmave nga të gjithë do të ndikoj në minimizimin e varfërisë së skajshme	Pjesëmarrja e faktorëve relevant
<b>SHËRBIMET SOCIALE</b>						
<b>OBJEKTIVAT</b>	<b>VEPRIMET</b>	<b>AFATI KOHORË</b>	<b>KOSTOJA FINANCIARE</b>	<b>PËRGJEGJËSIA</b>	<b>REZULTATET</b>	<b>VËSHTIRËSITË</b>
<b>1.Zbatimi i të gjitha ligjeve, rregulloreve dhe udhëzimeve administrative, do të jetë objektiv i QPS-së</b>	Monitorimi i zbatimit të ligjeve , udhëzimeve administrative dhe rregulloreve	Çdoherë		DSHMS, Departamenti i Politikës Sociale dhe Familjare(DPSF), Drejtori i QPS-së, Udhëheqësi i Shërbimit Sociale, zyrtarët e shërbimeve sociale	Ofrimi i shërbimeve më të avancuara konform ligjit dhe konventave ndërkombëtare	

<p>2.Mbrojtja dhe mirëqenia e individit dhe familjes</p>	<p>1.Bashkimi familjar Edhe gjatë këtij viti do të jetë bashkimi familjar për fëmijët e braktisur, natyrisht aty ku ka mundësi , ndërsa aty ku nuk ekziston mundësi do të aplikohen forma tjera të mbrojtje</p>	<p>I përhershëm</p>		<p>DSHMS, DPSF, QPS, OJQ-të etj.</p>	<p>Mbrojtja më e mirë e fëmijëve të braktisur</p>	<p>Ndikimi i rrethit , si dhe përkrahja e familjeve të rasteve të tilla</p>
	<p><b>2.Strehimi familjar</b> Rastet e fëmijëve pa përkujdesje prindërore do të strehohen tek të afërmit, ku pagesa mujore për një fëmijë do të jetë 150€. Rastet e fëmijëve të braktisur dhe të keqtrajtuar do të jenë prioritet.</p>	<p>I përhershëm</p>		<p>DPSF, DSHMS QPS, Familjet strehuese</p>	<p>Ofrimi i shërbimeve më të mira dhe ngrohtësia familjare për fëmijët</p>	<p>Familjet strehuese hezitojnë të marrin fëmijë</p>

	<p><b>3.Birësimi (Adoptimi)</b>  QPS lidhur me këtë kategori do të respektoj ligjet dhe udhëzimet në fuqi, konventat ndërkombëtare etj.  Detyrë permanente e zyrtarëve të shërbimit social do të jetë gjetja e familjeve për birësim brenda Kosovës.Vetëm atëherë kur shterren këto mundësi dhe kur të jetë në interes të fëmijut do të bëhet adoptimi jasht vendit me pëlqimin e panelit të DPSF-së për adoptim.</p>	I përhershëm		Shërbimi social, DPSF Familjet adoptuese	Zgjedhja e familjes sa më të përshtatshme do të jetë motoja jonë.	
--	---	--------------	--	--	---	--

	<p><b>4. Kujdestaria</b></p> <p>Institucioni i kujdestarisë do të aplikohet konform ligjit në fuqi. Për fëmijët që për arsye të ndryshme kanë mbetur pa përkujdesje, do të bëhet përpjekje që për kujdestar të caktohen të afërmit e fëmijut.</p>	I përhershëm		<p>QPS</p> <p>DSHMS</p> <p>Kujdestari ligjor</p>	<p>Një përkujdesje më e mirë për fëmijët pa përkujdesje.</p>	
	<p><b>5. Mbrojtja e delikuinteve të mitur</b></p> <p>Konform ligjit penal për të mitur, QPS do të qaset kësaj kategorie të të miturve. Do të kemi një bashkëpunim me shërbimin sprovues.</p>	I përhershëm		<p>QPS</p> <p>Shërbimi social</p> <p>SHPK</p> <p>Gjykatat</p> <p>Shërbimi sprovues</p> <p>Familja e të miturit</p>	<p>Përmirësimi i sjelljeve të të miturve si dhe riintegrimi i tyre në shoqëri</p>	
	<p><b>6. Fëmijët e rrezikuar dhe abuzuar</b></p> <p>Shërbimi social do të ketë kujdes të veçantë për këtë kategori të fëmijëve, do të ketë bashkëpunim me të gjitha institucionet relevante.</p>	I përhershëm		<p>QPS</p> <p>Shërbimi sprovues</p> <p>SHPK</p> <p>Gjykatat</p> <p>Shkollat etj.</p>	<p>Riintegrimi dhe risocializimi i të miturve në shoqëri</p>	

